



Datë: 04.08.2025
Numër Protokolli: 5234/2025

A.nr. 1087/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Ardita Haxhnikaj–Demi dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Rushit Kajtazi- në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.1087/2025, të datës 05.06.2025, të parashtruar nga ankuesja A.S-M, kundër organit të punësimit: Ministria e Punëve të Brendshme në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe në mbështetje të Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 04.08.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1087/2025, e datës 05.06.2025, e parashtruar nga ankuesja A.S-M.

II. Mbetet në fuqi, Njoftimi me numër protokolli 890 i datës 14.05.2025, lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidateve të suksesshëm për pozitën ‘Zyrtar për Regjistrimin Civil’ në Viti, i nxjerr nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesja, A.S-M (me tej referuar vetëm ankuesja), më datë 05.06.2025 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar nën shenjë A.nr.1087/2025, lidhur me konkursin me numër referencës RN00016731, për Grup i Administrimit të Përgjithshëm për pozitën “Zyrtar për Regjistrim Civil”, DPD-Viti, me Profesional 2, numri i kërkuar 2, pozita me pretendimet ankimore se pas pranimit të aplikacionit nuk jam përzgjedhur për të hyrë në testim me shkrim me arsyen që nuk kam dërguar diplomën e bachelorit por vetëm të masterit, dhe se për të njëjtën pozitë kam konkurruar edhe me datë 10.08.2024 dhe me është pranuar aplikimi dhe se kam vazhduar në testim me shkrim, i cili është anuluar për të gjithë, dhe në këtë rast unë mendojë se më është bërë padrejtësi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 13.06.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën tek Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa kjo e fundit, më datë 04.07.2025, ka dorëzuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave administroi këto prova; Ankesën A.Nr. 1087/2025 të datës 05.06.2025, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit për ankuesen; Diplomë me numër protokolli 1299, të datës 22.06.2010, për A.M, e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 13.06.2025, dërguar përmes emailit, nga R.K për A.G; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 1087/2025, e datës 04.07.2025; Konkursi me numër referencë RN00016731, i datës 14.02.2025; Lista e Aplikantëve; Vendimi me numër protokolli 536, i datës 01.04.2025; Njoftimi me numër protokolli 613, i datës 11.04.2025; Njoftimi, i datës 06.05.2025; Njoftimi me numër protokolli 890, i datës 14.05.2025; lidhur me përzgjedhjen përfundimtare të kandidateve; Njoftimi i datës 31.03.2025; Aplikacioni i A.M, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 667, e datës 18.03.2016, për A.S e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës ‘‘Hasan Prishtina’’; Certifikatë për A.M; Vërtetim për A.S; Kontratë Konsulentë me numër protokolli Nr. 11-03/11; Vërtetim i datës 08.01.2013; Vërtetim i datës 16.01.2014; Vërtetim i datës 19.04.2018; Vërtetim i datës 05.08.2019; Pasqyra e trustit për A.M, për periudhën nga data 13.07.2015, deri me datën 02.08.2024; Aplikacioni i E.H.S, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 565, e datës 01.12.2021, për E.H e lëshuar nga Universiteti i Publik ‘‘ Kadri Zeka’’; Vërtetim për E.S; Pasqyra e trustit për E.S për periudhën nga data 06.03.2024, deri me datën 05.03.2025; Kopje e letërnjoftimit për E.S; Vërtetim për E.S; Aplikacioni i Y.Xh.M, me shkresat e bashkangjitura; Diplomë me numër protokolli 1795, e datës 21.01.2013, për Y.Xh e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës; Certifikatat për Y.XH; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 16.06.2014; Referencë e datës 16.05.2014; Kopjen e letërnjoftimit për Y.XH; Kontratë për Punë e datës 25.03.2024; Deklaratë e datës 10.03.2025; Marrëveshje për shërbime të veçanta e datës 13.10.2014; Vërtetim i datës 22.09.2014; Vërtetim i datës 01.03.2012.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses, është e pabazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se Ministria e Punëve të Brendshme më datë 14.02.2025 ka shpallur konkursin me numër reference RN00016731, për Grup i Administrimit të Përgjithshëm, pozita ‘‘Zyrtar për Regjistrim Civile’’ Agjencia e Regjistrimit Civil DPD-Viti klasa e pozitës Profesional 2 ’’, numri i kërkuar 2, pozita ku afati për aplikim ka qenë nga data 15.02.2025 deri më 16.03.2025, ndërsa sipas shkresave të lëndës, në konkurs ka aplikuar dhe ankuesja.

Tutje, Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me datë 14.05.2025, me numër Protokolli 890, ka publikuar njoftimin lidhur me kandidatet fituese, nga i cili njoftim rezulton se kandidatja Elira Haliti-Sahiti është vlerësuar me gjithsejtë 96.8, pikë, kandidatja Y. XH- M është vlerësuar me gjithsejtë 90.8, pikë, ndërsa ankueses A.S-M, përmes njoftimit të datës 31.03.2025, të nxjerr nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se ankuesja nuk posedon diplomën e arsimit të nivelit të parë Bachelor.

Ankuesja A.S-M i pakënaqur me procedurën e rekrutimit, me datë 05.06.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendimet ankimore Sikur janë shënuar në hyrje të këtij arsyetimi.

Në kuptim të dispozitave të nenit 89 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, si dhe në kontest të shqyrtimit të pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar konkursin me numër të referencës RN00016731 për Grup i Administrimit të Përgjithshëm ’’, për pozitën ‘‘ Zyrtar për Regjistrimin Civil, Agjencia e Regjistrimit Civil, Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente- Viti klasa e pozitës Profesional 2 ’’, numri i kërkuar 2, pozita, Profesional 2, dhe për pasojë konstatoi se si kritere të përgjithshme formale për pozitën përkatëse të punës kanë qenë:

Arsimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor) **Arsim i Lartë i Paspecifikuar**
Përvoja e punës e kërkuar: Së paku 1 (1) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se kriteret e konkursit për pozitën Zyrtar për Regjistrimin Civil, Agjencia e Regjistrimit Civil, Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente- Viti klasa e pozitës Profesional 2”, numri i kërkuar 2, pozita , Profesional 2, “, kanë qenë në pajtim me kanë qenë në pajtim me Rregulloren (QRK) nr. 06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, si dhe në pajtim me Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës. Po ashtu Kolegji i Këshillit ka analizuar dosjet e kandidatëve fitues E.S dhe Y.M dhe ka konstatuar se të njëjta i kanë plotësuar kriteret lidhur me arsimimin e kërkuar si dhe përvojën e punës ashtu siç ka qenë e përcaktuar me konkurs për pozitën e lartcekura.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i provave materiale të kësaj çështje ka gjetur se Komisioni i Pranimit, i themeluar sipas vendimit me numër protokollit 552/2025, të datës 04.04.2025, të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme, përgjegjëse për vlerësimin profesional të kandidatëve në këtë procedurë të rekrutimit, ka qenë komisioni në këtë përbërje: znj. A.V Kryesuese e Komisionit, e cila sipas Akt emërimit të datës 01.07.2024 , mbanë pozitën e punës “Udhëheqëse e Qendrës për Pajisje me Dokumente”, z. F.LL, i cili sipas Akt emërimit të datës 01.07.2024 , mbanë pozitën e punës “ Udhëheqëse i Qendrës të Regjistrimit të Automjeteve”, z. E.A, i cili sipas Akt emërimit të datës 01.08.2024 , mbanë pozitën e punës “ Udhëheqës i Qendrës për Regjistrimin e Automjeteve”, znj. B. S, cila sipas Akt emërimit të datës 13.10.2011 , mbanë pozitën e punës “ Zyrtare e Lartë e Personelit”, z. A.B, i cili sipas Akt emërimit të datës 01.08.2024 , mbanë pozitën e punës “ Nëpunës Administrativ në QKRA, Obiliq. Rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se komisioni i pranimit, ka qenë në përputhje me nenin 40, paragrafi 1,2, nen paragrafi 2.1,2.2,2.3 Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, ku thuhet se: 1. Vlerësimi profesional i kandidatëve/eve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale bëhet nga komisioni i pranimit. 2. Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë/e, në këtë përbërje: 2.1. tre (3) nëpunës/e civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas grupit për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. një (1) përfaqësues/e nga njësia përgjegjëse; dhe 2.3. një (1) nëpunës/e i kategorisë profesionale të fushës përkatëse për kategorinë profesionale, si dhe nenit 20, paragrafi 1, 2, nen paragrafi 2.1,1.2 dhe 2.3 të Rregullores (QRK) NR. 15/2023 Për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil, ku përcaktohet se;1. Komisioni i pranimit për vlerësimin profesional të kandidatëve për pranim në shërbim civil në pozitë të kategorisë profesionale themelohet me vendim të Zyrtarit Kryesor Administrativ të institucionit që zhvillon procedurën e rekrutimit për institucionet e administratës shtetërore. Komisioni i pranimit në institucionin tjetër themelohet me vendim të titullarit të institucionit. 2.Komisioni i pranimit ka pesë (5) anëtarë, në këtë përbërje:2.1. tre (3) nëpunës civil të nivelit të mesëm apo të ulët drejtues të specializuar në fushën përkatëse sipas pozitës për të cilin zhvillohet konkurrimi;2.2. një (1) përfaqësues nga NjMBNj; dhe 2.3. një (1) nëpunës i kategorisë profesionale i fushës përkatëse.

Thënë me tepër, Kolegji për vendosje të drejtë dhe meritorie iu referua nenit 39 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtarët Publik, më të cilin është përcaktuar se: Procedura e pranimit në Shërbimin Civil 1. Pranimi në shërbimin civil bëhet në të gjitha kategoritë e shërbimit civil, nëpërmjet një procedure rekrutuese të hapur dhe publike, përveç kur parashikohet ndryshe me këtë ligj.2.Rekrutimi për kategorinë profesionale organizohet për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe pozitë apo grup pozitash të administrimit të veçantë, sipas nevojës së institucionit dhe sipas planifikimit të NjMBNj-së. 3. Rekrutimi për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë organizohet nga njësia përgjegjëse. 4. Përrjashtimisht përcaktimeve të këtij ligji, për institucionet që kanë nëpunës/e civil me status të veçantë, procedurat e rekrutimit i zhvillon NjMBNj e atij institucioni.

5. Shpallja e procedurës së rekrutimit për pozitë apo grup pozitash të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, bëhet nga njësia përgjegjëse në SIMBNj-së, si dhe me mjete të tjera të përshtatshme të informimit. 6. Pranimi i aplikacioneve bëhet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e shpalljes së procedurës së rekrutimit. 7. Konkurrimi zhvillohet në dy (2) faza: 7.1. verifikimi paraprak përmes të cilit verifikohet nëse kandidatët i plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta, sipas shpalljes së konkursit; dhe 7.2. vlerësimi profesional që përfshin vlerësimin e njohurive dhe cilësive profesionale të kandidatëve. 8. Verifikimi paraprak kryhet nga njësia përgjegjëse, ndërsa vlerësimi profesional i kandidatëve bëhet nga komisioni i pranimit i krijuar për secilin grup të administrimit të përgjithshëm apo administrimit të veçantë, për të cilin zhvillohet rekrutimi. Vlerësimi profesional i kandidatëve përfshin testim me shkrim në formë elektronike ku sigurohet anonimiteti i konkurrentëve, si dhe intervistë me gojë. 10. Totali i pikëve të vlerësimit të kandidatëve është njëqind (100) pikë. 11. Në përfundim të vlerësimit, kandidatja/i fitues konsiderohet kandidatja/i i vlerësuar me më së shumti pikë, por jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70 %) të pikëve totale të vlerësimit. Të gjithë kandidatët/ët njoftohen individualisht me rezultatet e procesit të rekrutimit. Lista e kandidateve/ëve që kanë kaluar pragun prej shtatëdhjetë për qind (70%) të pikëve totale publikohet në SIMBNj-së, si dhe në ueb faqen e institucionit përkatës.

Referuar kuadrit ligjor si me lart Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidates E. H-S, të shpallur fitues dhe si rrjedhojë ka gjetur se e njëjta posedon Diplomë universitare numër protokolli 565, të datës 01.12.2021, të leshur nga Universiteti Publik “Kadri Zeka”, sipas së cilës ka përfunduar studimet themelore Bachelor në Arsim Fillor, me përvojë punë sipas vërtetimit të lëshuar nga Master Plus Team, me çka dëshmohet se nga data 28.10.2023, deri me datën 30.10.2024, ka mbajtur pozitën Punëtorë Administrative”, të cilën përvojë të punës e ka dëshmuar edhe me trust, prandaj e njëjta ka plotësuar kriteret sipas 3 të konkursit të lartshënuar.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar dosjen e kandidates Y.Xh-M,, të shpallur fitues dhe si rrjedhojë ka gjetur se e njëjta posedon Diplomë universitare numër protokolli 1795, të datës 21.01.2013, të leshur nga Universiteti i Prishtinës sipas së cilës ka përfunduar studimet themelore me datë 12.09.2012 dhe ka marrë titullin Jurist i Diplomuar–Bachelor, me përvojë punë sipas Vërtetimit me numër protokolli 112/12, të datës 01.03.2012, të lëshuar nga Menaxherja e Personelit e Ministrisë së Punëve të Brendshme, nga data 20.09.2011, deri me datën 27.02.2012, ka mbajtur pozitën Praktikantë në QKRC, në Viti, sipas marrëveshje për shërbime të veçanta, kjo përvojë punë është para datës së diplomimit, marrëveshja për shërbime të veçanta me numër protokolli 396, të datës 16.06.2014, e lidhur me Ministrinë e Punëve të Brendshme, lidhur me strategjinë për ri-integrimin e personave të Riatdhesuara, nga data 18.06.2014 deri me datë 30.09.2014, ku pozita nuk është përcaktuar vetëm janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë; sipas marrëveshjes për shërbime të veçanta me MPB nr.prot 633 të datës 13.10.2014, ku pozita nuk është përcaktuar vetëm janë përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë nga data 01.10.2014 deri më datë 31.12.2014, ndërsa sipas Kontratës së Punës me numër protokolli 0606-627, të datës 25.03.2024, e lidhur me Agjencinë e Statistikave të Kosovës, nga data 22.03.2024, deri me datë 04.06.2024, në pozitën e Mbikëqyrësit” Ekonomi familjare dhe Banesave, dhe sipas vërtetimit nr.69/2014 të datës 22.09.2014 nga data 18.02.2014 deri më datë 17.06.2014 praktikante vullnetare në SKGHHK, prandaj kandidatja Y.XH.M ka gjithsejtë 12 muaj e 16 ditë përvojë pune në harmoni me dispozitat ligjore në fuqi.

Andaj, bazuar në rrethanat dhe konstatimet si me sipër, Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e Ministrisë së Punëve të Brendshme, me rastin e shpalljes së Njoftimit me numër protokolli 890 të datës 14.05.2025 për Renditjen përfundimtare të kandidatit për pozitën e punës ‘Zyrtar për Regjistrimin Civil, Agjencia e Regjistrimit Civil, Drejtoria e Pajisjeve me Dokumente- Viti, sipas konkursit me numër reference RN00016731, ka zbatuar drejtë ligjin material, duke vepruar kështu në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publikë, si dhe Rregullores Nr.15/2023 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kolegji i Këshillit, nga shkresat e lëndës ka konstatuar së anëtari zëvendësues z, F.K, i cili sipas Vendimit për transferimin e përhershëm me numër protokolli 651, të datës 25.04.2025, mbanë pozitën e punës Zyrtar për Regjistrim Civil, në Qendrën për Pajisje me dokumente në Prishtinë, të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme si dhe anëtari zëvendësues M.Sh, i cili sipas akt emërimit të datës të datës 21.01.2023, mbanë pozitën Koordinator i QKRS – Viti, të emëruar sipas vendimit me numër protokolli 552/2025, të datës 04.04.2025, të nxjerr nga Sekretarja e Përgjithshme e Ministrisë së Punëve të Brendshme.

Kështu që për sa me sipër dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në diapozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS LËNDA ME NUMËR A.NR. 1087/2025

Rushit Kajtazi

Procesmbajtës

Eshref Shabani

Kryetar i Kolegji

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, A.S-M;
- Divizionit për Burime Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- dhe Arkivit të KPMSHCK-së